**Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj**

**Pasqyrat Financiare**
**me dhe per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2019**

**PERMBAJTJA:** **FAQE**


| | |
|---|---|
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 3 |
| PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE | 4 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL | 5 |
| PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE | 6 |
| SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE | 7-24 |

**Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2019**
*(Shumat ne LEK)*

| | Shenime | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| **Aktive** | | | |
| **Aktivet afatgjata** | | - | - |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | | - | - |
| **Aktivet afatshkurtra** | | | |
| Llogari te arketueshme | 6 | 97,741,980 | 54,015,296 |
| Te ardhura te perllogaritura | 7 | 10,965,658 | - |
| Aktive te tjera | 8 | 7,132,710 | 1,942,772 |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre | 9 | 19,581,138 | 17,239,427 |
| **Totali i aktiveve afatshkurtra** | | **135,421,486** | **73,197,495** |
| **Totali i aktiveve** | | **135,421,486** | **73,197,495** |
| **Kapitali dhe detyrime** | | | |
| **Kapitali** | | | |
| Humbja e akumuluar | | (7,167,446) | (14,288,065) |
| Fitimi i vitit | | 28,328,901 | 7,120,619 |
| **Totali i kapitalit** | | **21,161,455** | **(7,167,446)** |
| **Detyrime afatgjata** | | | |
| Fonde te marra nga Shoqeria Meme | 10 | 19,483,200 | 43,207,300 |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | **19,483,200** | **43,207,300** |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | |
| Llogari te pagueshme | 11 | 34,999,955 | 18,745,910 |
| Shpenzime te perllogaritura | 12 | 11,118,458 | 1,215,811 |
| Llogari te pagueshme ndaj punonjesve | 13 | 34,549,389 | 12,350,576 |
| Detyrime tatimore | 14 | 12,208,005 | 4,384,268 |
| Tatimi mbi fitimin i pagueshem | 20 | 1,901,024 | 461,076 |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | **94,776,831** | **37,157,641** |
| **Totali i detyrimeve** | | **114,260,031** | **80,364,941** |
| **Totali i detyrimeve dhe i kapitalit** | | **135,421,486** | **73,197,495** |

Keto Pasqyra Financiare jane hartuar nga Deloitte Albania shpk dhe jane miratuar dhe nenshkruar nga perfaqesuesi ligjor i Shoqerise Brunel Energy Europe B.V- Dege e Shoqerise se Huaj me __.__.2020:

**Hartuesi**
Deloitte Albania Shpk
Violeta Perleka

DELOITTE ALBANIA
Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010 Tiranë
Tirana - Albania
Tel:+355 44517 920/ Fax:+355 4 45 17990
NIPT: J 62329003 N

**Perfaqesuesi Ligjor**
Peter Alexsander De Laat

Brunel Energy Europe B.V.
Dege e shoqerise se huaj
NIPT: L 51816002 Q
Adresa: Rr Elbasanit, Pallati Nr. 1, Ap. 2
Tiranë - Albania

*Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 24, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

**Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te tjera Gjitheperfshirese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019**

*(Shumat ne LEK)*

| | Shenime | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| **Te ardhurat** | | | |
| Te ardhura nga sherbimet | | 510,057,922 | 167,316,370 |
| Te ardhura te tjera | | 10,286,546 | - |
| **Totali i te ardhurave** | **15** | **520,344,468** | **167,316,370** |
| **Shpenzimet** | | | |
| Shpenzime personeli | **16** | (426,820,559) | (140,215,403) |
| Shpenzime operative | **17** | (55,482,994) | (24,444,777) |
| Shpenzime te tjera | **18** | (236,508) | - |
| **Totali i shpenzimeve** | | **(482,540,061)** | **(164,660,180)** |
| **Fitimi nga aktiviteti operacional** | | **37,804,407** | **2,656,190** |
| **Fitim (Humbja) nga kurset e kembimit** | | | |
| Fitim (Humbja) nga kurset e kembimit | **19** | (2,241,208) | 6,563,141 |
| **Fitim (Humbja) neto nga kurset e kembimit** | | **(2,241,208)** | **6,563,141** |
| **Fitimi para tatimit** | | **35,563,199** | **9,219,331** |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | **20** | 7,234,298 | 2,098,712 |
| **Fitim neto per vitin** | | **28,328,901** | **7,120,619** |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin | | - | - |
| **Totali i te ardhurave gjitheperfshire per vitin** | | **28,328,901** | **7,120,619** |

*Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjitheperfshirese duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 24, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

## Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

*(Shumat ne LEK)*

| | Fitimi i akumuluar | Totali |
|---|---|---|
| **Gjendja me 1 janar 2018** | **(14,288,065)** | **(14,288,065)** |
| Fitimi neto i vitit financiar | 7,120,619 | 7,120,619 |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese | - | - |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2018** | **(7,167,446)** | **(7,167,446)** |
| **Gjendja me 1 janar 2019** | **(7,167,446)** | **(7,167,446)** |
| Fitimi neto i vitit financiar | 28,328,901 | 28,328,901 |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese | - | - |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2019** | **21,161,455** | **21,161,455** |

*Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 24, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

**Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019**
*(Shumat ne LEK)*

| | Shenime | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| **Flukset e mjeteve monetare gjeneruar nga (te perdorura ne) veprimtarite e shfrytezimit** | | | |
| Fitimi para tatimit | | 35,563,199 | 9,219,331 |
| **Ndryshimet ne kapitalin punues:** | | | |
| Rritje ne aktive te tjera | **8** | (5,189,939) | 1,752,403 |
| Rritje ne llogarite e arketueshme | **6** | (43,726,684) | (31,349,087) |
| Rritje ne te ardhura te perllogaritura | **7** | (10,965,658) | - |
| Rritje ne detyrime tatimore | **14** | 5,922,713 | (679,070) |
| Rritje ne tatimin mbi fitimin e pagueshem | **20** | 1,439,948 | 461,076 |
| Rritje ne shpenzime te perllogaritura | **12** | 9,902,648 | 484,586 |
| Rritje ne llogarite e pagueshme | **11** | 16,254,045 | 9,391,141 |
| Rritje ne llogarite e pagueshme ndaj punonjesve | **13** | 22,198,813 | 4,534,095 |
| **Paraja e perdorur ne veprimtarite e shfrytezimit** | | **31,399,085** | **(6,185,525)** |
| Tatimi mbi fitimin i paguar | | (5,333,274) | (1,637,636) |
| **Flukset e mjeteve monetare te perdorura ne veprimtarite e shfrytezimit** | | **26,065,811** | **(7,823,161)** |
| **Flukset e mjeteve monetare gjeneruar nga (te perdorura ne) veprimtarite e investimit** | | | |
| **Flukset e mjeteve monetare te perdorura ne veprimtarite e investimit** | | - | - |
| **Flukset e mjeteve monetare gjeneruar nga (te perdorura ne) veprimtarite e financimit** | | | |
| Fonde te dhena Shoqerise Meme | **10** | (23,724,100) | (70,042,953) |
| **Flukset e mjeteve monetare te perdorura ne veprimtarite e financimit** | | **(23,724,100)** | **(70,042,953)** |
| **Renie neto e mjeteve monetare** | | **2,341,711** | **(77,866,114)** |
| **Mjetet monetare dhe ekuivalente te tyre ne 1 janar 2019** | **9** | **17,239,427** | **95,105,542** |
| **Mjetet monetare dhe ekuivalente te tyre ne 31 dhjetor 2019** | **9** | **19,581,138** | **17,239,427** |

*Pasqyra e flukseve te mjeteve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 24, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

## 1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj (referuar ne vijim si "Dega") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne daten 18 maj 2015, si dege e shoqerise se huaj, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar. Perfaqesues ligjore te Deges jane Z. Johan Hardy Flohr dhe Z. Peter Aleksander De Laat, te dy shtetas hollandez. Shoqeria Meme eshte Brunel Energy Europe B.V., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara me kapital ne shumen 18,000 Euro, e themeluar ne Hollande me 20 shkurt 2003.

Objekt i veprimtarise se Deges eshte te ofroje sherbime dhe keshillime per sipermarrjet industriale, vecanerisht sipermarrjet qe ushtrojne veprimtari ne fushen e industrise se vajit dhe gazit, kimise, industrise petrokimike dhe industrise se energjise. Gjate vitit 2019, Dega ka pasur marredhenie kontraktuale me Trans Adriatic Pipeline AG, Dega ne Shqiperi (ketej e tutje referuar si "TAP").

Bazuar ne nenin 41 te Ligjit "Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar", Shoqeria detyrohet te kryeje auditimin ligjor te Pasqyrave Financiare, perpara publikimit te tyre.

Dega me 31 dhjetor 2019 ka deklaruar mesatarisht 19 punemarres (31 dhjetor 2018: 9 punemarres).

Pergatitesi i pasqyrave financiare eshte shoqeria Deloitte Albania Shpk me NIPT J62329003N, dhe me numër licence 21, me objekt aktiviteti sherbime kontabiliteti, konsulence te biznesit dhe menaxhimit, sherbime te vleresimit te aseteve e te biznesit, sherbime ligjore.

## 2. BAZA E PERGATITJES

### 2.1 Deklarata e perputhshmerise se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

### 2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

### 2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten ne Lek, e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e shoqerise.

### 2.4 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF-te kerkon qe Drejtimi te kryeje gjykime, vleresime dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe shumave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime. Vleresimet dhe supozimet kryesore rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhme nese ato ndikohen. Ne veçanti, informacioni mbi elemente te rendesishem te vleresimit te pasigurise dhe gjykimit kritik ne zbatimin e politikave kontabel qe kane nje efekt shume te rendesishem ne shumen e njohur ne pasqyrat financiare, pershkruhet ne shenimet shpjeguese perkatese te pasqyrave financiare.

## 2. BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)

### 2.5 Parimi i vijimesise

Zhvillimi i shpejte i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik ne Shqiperi dhe globalisht mund te rezultoje ne supozime dhe vleresime qe kerkojne rishikime te cilat mund te çojne ne rregullime materiale te vleres se mbetur te aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit te ardhshem financiar. Ne veçanti Drejtimi pret qe supozimet dhe vleresimet e perdorura ne percaktimin e rikuperueshmerise se aktiveve, lindja e detyrimeve te reja dhe perllogaritjet kontabel te preken. Ne kete faze Drejtimi nuk eshte ne gjendje te vleresoje ne menyre te besueshme ndikimin pasi ngjarjet lidhur me Covid -19 po sjellin zhvillime te reja dita-dites. Ndikimi afatgjate mund te ndikoje gjithashtu ne vellimet e tregtimit, flukset e parave, dhe perfitueshmerine e Shoqerise. Sidoqofte, ne daten e ketyre pasqyrave financiare, Shoqeria vazhdon te permbushe detyrimet e saj sipas kushteve dhe pret qe t'i permbushe ato edhe me mbeshtjetjen e Shoqerise Meme per 12 muajt e ardhshem. Per kete arsye vazhdon te zbatoje parimin e vijimesise, duke marre parasysh edhe pozicionin financiar te Shoqerise Meme, objektivat aktuale, perfitueshmerine e operacioneve dhe aksesin ne burimet financiare.

## 3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

### 3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit.

Aktivet dhe detyrimet jomonetare te shprehuara me kosto historike nuk konvertohen me kursin e dates se raportimit. Diferencat nga kurset e kembimit nga elementet monetare njihen ne te ardhurat dhe shpenzimet e periudhes kur ato shfaqen.

Kurset e kembimit ne fund te periudhes se raportimit dhe periudhes parardhese te raportimit jane si vijon:

| | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| **EURO** | 121.77 | 123.42 |
| **GBP** | 143.00 | 137.42 |
| **USD** | 108.64 | 107.82 |

### 3.2 Aktivet afatgjata materiale

*(i) Njohja dhe matja*

Dega nuk ka patur aktive afatgjata materiale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019. Megjithate, sipas politikave kontabel qe ajo zbaton zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvleresimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi (shih politiken kontabel 3.3). Kur pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si elemente te veçanta te aktiveve afatgjata.

## 3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.2 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

*(ii) Kostot vijuese*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren e mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te ardhme qe i atribuohen atij elementi t'i perkasin Deges, dhe nese kostoja e tij mund te matet me besueshmeri.

Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

*(iii) Zhvleresimi*

Aktivet afatgjata materiale zhvleresohen bazuar ne metoden e vleres se mbetur. Amortizimi njihet ne fitim ose humbje gjate jetes se dobishme te aktiveve. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nese eshte e konsiderueshme) rivleresohen ne daten e raportimit.

### 3.3 Renia ne vlere e aktiveve jofinanciare

Ne çdo date raportimi Dega rishikon vleren kontabel te aktiveve jofinanciare, perveç inventarit dhe aktiveve tatimore te shtyra, per te percaktuar nese ka tregues per reniet e vleres. Nese ka tregues te tille, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit ne menyre qe te percaktohet renia ne vlere. Vlera e rikuperueshme e nje aktivi ose njesise gjeneruese te parase eshte vlera me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte minus koston e shitjes.

Per percaktimin e vleres ne perdorim, skontohen rrjedhat e ardhshme te parase duke perdorur normen e skontimit para tatimit, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqeve specifike te aktivit. Per qellime te testimit te renies ne vlere, aktivet grupohen se bashku ne grupin me te vogel te tyre i cili gjeneron rrjedha parash nga perdorimi i vazhdueshem i tyre dhe qe jane te pavarura nga rrjedhat e parase te aktiveve ose grupeve te tjera te aktiveve ("njesia gjeneruese e parase").

Nje humbje nga renia ne vlere njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi apo e njesise se tij gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga renia ne vlere njihen ne pasqyren e fitimit ose humbjes. Humbjet nga renia ne vlere, qe jane njohur ne periudhat e meparshme, vleresohen ne çdo date raportimi nese ka evidence qe humbja eshte ulur ose nuk ekziston me.

### 3.4 Inventaret

Dega nuk ka mbajtur inventar gjate vitit 2019. Megjithate, sipas politikave kontabel qe ajo zbaton inventaret maten me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kosto percaktohet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme eshte çmimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit minus kostot e vleresuara per perfundimin dhe realizimin e shitjes. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renies ne vlere te inventareve deri ne vleren e realizueshme neto si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

## 3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.5 Instrumentet financiare

Dega mban vetem instrumente financiare joderivative, qe perfshijne llogari te arketueshme, aktive te tjera, mjete monetare dhe ekuivalente me to, fonde te marra nga Shoqeria Meme dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare joderivative jane matur fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejte me pervetesimin e tyre.

Nje instrument financiar njihet ne rast se Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat kontraktuale te Deges ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivi financiar mbarojne ose nese Dega i transferon aktivin financiar nje pale tjeter, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te nje aktivi financiar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh. daten ne te cilen Dega zotohet te bleje ose te shese aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e Deges te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane anulluar.

Pas njohjes fillestare instrumentet financiare joderivative vleresohen si me poshte:

*Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat monetare te mbajtura ne llogari rrjedhese ne banka, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere dhe perdoren nga Dega ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

*Llogari te arketueshme*

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara me humbjet nga renia ne vlere.

*Llogari te pagueshme*

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

*Fondet te marra nga Shoqeria Meme*

Dega ka marre financime (fonde) nga Shoqeria Meme, te cilat njihen fillimisht me vleren e drejte. Huamarrjet mbarten ne vijim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga renia ne vlere.

*Te tjera*

Instrumenta financiare te tjere joderivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga renia ne vlere.
Metoda e interesit efektiv eshte nje metode per llogaritjen e kostos se amortizuar te nje aktivi ose detyrimi financiar dhe per shperndarjen e te ardhurave ose shpenzimeve te interesit pergjate periudhes perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe skonton plotesisht pagesat e ardhshme te vleresuara pergjate jetes se pritshme te instrumentit financiar ose, kur eshte e pershtatshme, pergjate nje periudhe me te shkurter me vleren e mbartur neto te aktivit ose detyrimit financiar. Kontabiliteti per te ardhurat dhe shpenzimet financiare shtjellohet ne politiken kontabel 3.8.

## 3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.5 Instrumentet financiare (vazhdim)

*Renia ne vlere e aktivit financiar*

Nje aktiv financiar konsiderohet te jete i zhvleresuar nese nje fakt objektiv tregon qe nje ose me shume ngjarje kane patur nje ndikim negativ ne flukset e ardhshme monetare te aktivit. Nje humbje nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar, llogaritet si diference midis vleres neto dhe shumes aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara te parase te skontuara me normen efektive origjinale te interesit.

Aktivet financiare te rendesishme individualisht i nenshtrohen testimit per zhvleresim mbi baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare jane te vleresuara se bashku, ne grupe qe shfaqin te njejtat karakteristika te rrezikut te kredise. Te gjitha diferencat nga zhvleresimi njihen si fitim ose si humbje. Nje humbje nga zhvleresimi kthehet mbrapsht ne qofte se kthimi mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi humbja nga zhvleresimi eshte njohur. Kthimi njihet ne pasqyren e fitimit ose humbjes.

### 3.6 Njohja e te ardhurave

E ardhura ne lidhje me kontraten me klientin eshte e njohur ne fitim ose humbje ne periudhen kur ofrohet sherbimi. Te ardhurat njihen ne baze te metodes kosto-plus sipas kushteve te kontrates.

### 3.7 Perfitimet e punonjesve

*Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Dega paguan kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension.

Qeveria Shqiptare eshte pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Deges ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

*Leje vjetore te paguara*

Dega njeh si detyrim vleren e paskontuar te kostove te vleresuara ne lidhje me lejet vjetore qe pritet te paguhen ne kembim per sherbimin e punonjesve gjate periudhes.

### 3.8 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi prej llogarive ne banka dhe fitimet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit dhe humbjet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje.

### 3.9 Shpenzimet

*Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

## 3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje perveç pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Dega nuk ka njohur tatim te shtyre ne pasqyren e Pozicionit Financiar, pasi nuk ka identifikuar diferenca te perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe bazes tatimore.

Detyrimi tatimor i shtyre njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme. Shuma e tatimit te shtyre eshte llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkallet tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit. Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem te jete i disponueshem kundrejt te cilit aktivi te mund te perdoret. Aktivi tatimor i shtyre zvogelohet per aq sa nuk eshte e mundur te realizohet perfitim fiskal.

### 3.11 Provigjonet

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve ne te kaluaren, Shoqerise i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) te cilat mund te parashikohen me besueshmeri dhe eshte e mundur qe te ndodhe nje dalje e perfitimeve ekonomike per shlyerjen e detyrimit. Nese efekti eshte material, provigjonet jane percaktuar duke ju zbritur vleren e pritshme te rrjedhes se mjeteve monetare te skontuara me nje norme para tatimit qe reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike te detyrimeve. Provigjonet rishikohen ne çdo date raportimi dhe nese nuk ka me mundesi qe nje rrjedhje burimesh qe perfshin perfitime ekonomike per shlyerjen e detyrimit, te jete e nevojshme per mbylljen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet perdoren vetem per qellimin per te cilin jane njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon per humbjet e ardhshme operative.

### 3.12 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Per nje detyrim te kushtezuar jepet informacion shpjegues vetem kur mundesia e nje daljeje burimesh qe perfshin perfitime ekonomike nuk ekziston me. Aktivet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i te ardhurave eshte i mundur. Shuma e humbjes se kushtezuar njihet si provigjon nese eshte e mundur qe ngjarje te ardhshme ta konfirmojne ate, nje detyrim qe ka lindur deri me daten e raportimit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i humbjes.

### 3.13 Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura perbehen nga aksionaret dhe drejtimi i Shoqerise, se bashku me entitetet qe kontrollojne, te cilet kane nje ndikim te rendesishem mbi aktivitetin dhe drejtimin e Shoqerise. Ne marrjen ne konsiderate te çdo marredhenie te mundshme me palet e lidhura, vemendja i drejtohet thelbit te marredhenies, jo vetem formes ligjore.

## 3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.14 Ngjarjet pas dates se raportimit

Ngjarjet pas dates se raportimit qe ofrojne informacion shtese ne lidhje me pozicionin fianânciar te Shoqerise ne daten e raportimit (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas dates se raportimit qe nuk jane ngjarje rregulluese jane paraqitur ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare te veçanta nese jane materiale.

## 4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA

### 4.1 Zbatimi fillestar i ndryshimeve te reja ne standardet ekzistuese ne fuqi per periudhen raportuese aktuale

Ndryshimet e meposhtme ne standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i leshuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK), jane ne fuqi per periudhen raportuese:

- **SNRF 16 "Qirate" (**efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas dates 1 janar 2019);
- **Ndryshime ne SNRF 9 "Instrumentet financiare"** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me dhe pas dates 1 janar 2019);

SNRF 9 "Instrumentat financiare", publikuar me 24 korrik 2014 eshte zevendesimi nga BSNK i SNK 39 “Instrumentat Financiare”.

SNRF 9 percakton kerkesat per njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa kontratave per blerjen apo shitjen e zerave jo-financiare. SNRF 9 perfshin kerkesat per njohjen dhe matjen, zhvleresimin, çregjistrimin dhe kontabilitetin e pergjithshem.

*Klasifikimi dhe matja* - SNRF 9 paraqet nje qasje te re per klasifikimin e aktiveve financiare, e cila eshte drejtuar nga karakteristikat e pasqyres se fluksit te mjeteve monetare dhe te modelit te biznesit sipas te cilit mbahet nje aktiv. Kjo qasje e bazuar ne parime, zevendeson kerkesat ekzistuese te bazuara ne rregullat sipas SNK 39. Modeli i ri rezulton gjithashtu ne nje model te vetem zhvleresimi qe aplikohet ne te gjitha instrumentet financiare. Kerkesat e reja te klasifikimit nuk kane nje ndikim material mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare.

*Zhvleresimi* - SNRF 9 zevendeson modelin e “humbjeve te ndodhura” te SNK 39 me modelin e “humbjeve te pritshme te kredise” (HPK). Modeli i ri i zhvleresimit do te aplikohet tek aktivet financiare te matura me koston e amortizuar, aktivet nga kontratat dhe instrumentet e borxhit me Vleren e Drejte nepermjet te Ardhurave te Tjera Gjitheperfshirese (VDATGJ), por jo per investimet ne instrumente kapitali. Sipas SNRF 9, humbjet nga mos arketimi njihen me heret se sipas SNK 39. Per aktivet subjekt i modelit te zhvleresimit sipas SNRF 9, humbjet nga zhvleresimi pergjithesisht priten qe te rriten dhe te behen me te luhatshme. Sipas SNRF 9, Shoqeria duhet te beje nje vleresim te HPK-se 12 mujore dhe HPK-ve pergjate jetes. Shoqeria vleresoi qe zbatimi i SNRF 9 “Instrumentat financiare” nuk do kete nje ndikim material ne zhvleresimin e aktiveve financiare.

## 4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

### 4.1 Zbatimi fillestar i ndryshimeve te reja ne standardet ekzistuese ne fuqi per periudhen raportuese aktuale (vazhdim)

- **Ndryshime ne SNK 19 "Perfitimet e punonjesve"** - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019);
- **Ndryshime ne SNK 28 "Investimet ne Shoqerite dhe Sipermarrjet e Perbashketa"** - Interesat Afatgjate ne Shoqerite dhe Sipermarrjet e Perbashketa (efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 janar 2019);
- **Ndryshime ne standarde te ndryshme per shkak te "Permiresimeve te SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** qe rezultojne nga projekti vjetor i permiresimit te SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qellim heqjen e mosperputhjeve dhe qartesimin e formulimit efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019);
- **KIFRN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi te Ardhurat"** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019).

Zbatimi i ketyre ndryshimeve ne standartet ekzistuese nuk ka ndikuar ne ndryshime materiale ne pasqyrat financiare te Deges.

### 4.2 Standarde te reja dhe ndryshime te standardeve ekzistuese te publikuara ende te pa-adoptuara

Ne daten e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet e reja, ndryshimet e standardeve ekzistuese dhe interpretimet e reja te meposhtme ishin te publikuara por ende jo efektive. Shoqeria nuk ka adoptuar asnje nga standardet, ndryshimet dhe interpretimet e publikuara por ende jo efektive.

Standardet dhe interpretimet e reja apo te ndryshuara nuk pritet te kene nje ndikim te rendesishem ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2021);
- **Ndryshime ne SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Perkufizimi i nje biznesi (efektive per kombinimet e bizneseve, per te cilat data e blerjes eshte ne ose pas fillimit te periudhes se pare te raportimin periodik qe fillon ne ose pas 1 janarit 2020 dhe per blerjen e aktiveve qe ndodhin ne dhe pas fillimit te asaj periudhe);
- **Ndryshime ne SNRF 9 "Instrumentet Financiare", SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Dhenie Informacionesh Shpjeguese"** - Reforma referuese per normat e interesit (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2020);
- **Ndryshime ne SNRF 10 "Pasqyrat Financiare te Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime ne Pjesemarrje"** - Shitja ose Kontributi i aktiveve midis nje Investitori dhe nje Pjesemarresi ose Shoqerie te Perbashket, se bashku me ndryshime te tjera (data efektive eshte shtyre pa afat deri ne perfundimin e projektit kerkimor mbi metodat e kapitalit neto);

## 4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

### 4.2 Standarde te reja dhe ndryshime te standardeve ekzistuese te publikuara ende te pa-adoptuara (vazhdim)

- **Ndryshime ne SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabel, Ndryshime ne Vleresimet Kontabel dhe Gabimet"** - Perkufizimi i materialitetit (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2020);
- **Ndryshime ne SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"** – Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra dhe Afatgjata (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2022);
- **Ndryshimet ne referencat e Kuadrit Konceptual per standardet SNRF** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2020).

Dega ka zgjedhur te mos zbatoje keto standarde te reja, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja perpara dates kur behen efektive. Shoqeria parashikon qe zbatimi ketyre standardeve, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do te kene ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise ne periudhen e zbatimit fillestar.

## 5. VLERESIME THELBESORE KONTABEL DHE BURIMET KRYESORE TE VLERESIMIT TE PASIGURISE

Dega pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me SNRF, zbatimi i te cilave zakonisht kerkon gjykimin e drejtuesve gjate vleresimit te pozicionit financiar dhe rezultatit te Deges. Sipas SNRF, Drejtimit i kerkohet te pershtase politikat kontabel per rrethanat e Deges, me qellim qe te beje nje paraqitje sa me te vertete dhe te besueshme te pozicionit financiar, performances dhe flukseve monetare.

Ne percaktimin dhe zbatimin e politikave kontabel, zakonisht kerkohet gjykimi per zera per te cilet zgjedhja e politikes specifike, vleresimet ose supozimet kontabel qe do te ndiqeshin, do te ndikonin materialisht ne rezultatet e raportuara ose pozicionin e aktiveve neto te Deges, ne rast se me vone do te percaktohej qe nje zgjedhje tjeter do te ishte me e pershtatshme. Burimet me kritike te pasigurise detajohen si me poshte:

*i) Te ardhurat e perllogaritura per punen e kryer*

Drejtimi perllogarit te ardhurat per punen qe eshte kryer, por qe nuk eshte faturuar tek klienti ne çdo date raportimi. Te ardhura te tilla varen nga miratimi i klientit, bazuar ne specifikimet e kontrates dhe rregullimet qe kerkohen per perllogaritjet e bera nga Dega kur klienti nuk pranon vleresimin e prezantuar nga drejtimi.

*ii) Percaktimi i vleres se drejte*

Vlera e drejte e mjeteve monetare, llogarive te arketueshme dhe te pagueshme eshte afersisht e barabarte me vleren kontabel neto per shkak te maturimit te tyre afatshkurter.

## 6. LLOGARI TE ARKETUESHME

Llogarite e arketueshme me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | Me 31 dhjetor 2019 | Me 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| ***Te arketueshme tregtare:*** | | |
| Trans Adriatic Pipeline AG - Dege e Shoqerise Huaj | 97,741,980 | 54,015,296 |
| **Totali** | **97,741,980** | **54,015,296** |

## 7. TE ARDHURA TE PERLLOGARITURA

Te ardhura te perllogaritura me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | Me 31 dhjetor 2019 | Me 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| ***Te ardhura te perllogaritura:*** | | |
| Te ardhura per sherbime te kryera dhe te pafaturuara ende | 10,965,658 | - |
| **Totali** | **10,965,658** | **-** |

## 8. AKTIVE TE TJERA

Aktive te tjera me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | Me 31 dhjetor 2019 | Me 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| ***Te arketueshme tatimore:*** | | |
| TVSH e arketueshme | 1,331,430 | 190,581 |
| Teprice kreditore e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore | 37,112 | 37,112 |
| ***Te arketueshme nga punonjesit:*** | | |
| Parapagime te dhena punonjesve | 5,764,168 | 1,715,079 |
| **Totali** | **7,132,710** | **1,942,772** |

Terprica kreditore e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore vjen si rezultat i mbipagesave te kryera gjate viteve te meparshme dhe nga efekti i kursit te kembimit si pasoje e pagesave te kontributeve te kryer nga Dega ne monedhe te huaj.

## 9. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre:*** | | |
| Llogari rrjedhese ne Euro – Raiffeisen Bank | 17,789,402 | 7,876,526 |
| Llogari rrjedhese ne Pound Britanik – Raiffeisen Bank | 926,793 | 9,019,861 |
| Llogari rrjedhese ne Lek – Raiffeisen Bank | 864,409 | 336,041 |
| Llogari rrjedhese ne Dollar – Raiffeisen Bank | 534 | 6,999 |
| **Totali** | **19,581,138** | **17,239,427** |

## 10. FONDE TE MARRA NGA SHOQERIA MEME

Fonde te transferuara nga Brunel Energy Europe B.V (Shoqeria Meme) me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Detyrime ndaj Shoqerise Meme:*** | | |
| Fonde te transferuara nga Brunel Energy Europe B.V | 19,483,200 | 43,207,300 |
| **Totali** | **19,483,200** | **43,207,300** |

## 11. LLOGARI TE PAGUESHME

Llogarite e pagueshme me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Llogari te pagueshme:*** | | |
| Brunel Energy Europe B.V | 32,393,552 | 17,565,151 |
| Brunel Energy Holding B.V | 2,240,445 | 1,180,759 |
| Deloitte Albania Sh.p.k | 365,958 | - |
| **Totali** | **34,999,955** | **18,745,910** |

## 12. SHPENZIME TE PERLLOGARITURA

Shpenzime te perllogaritura me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Shpenzime te perllogaritura:*** | | |
| Shpenzime te perllogaritura per fatura te pamberritura | 11,118,458 | 1,215,811 |
| **Totali** | **11,118,458** | **1,215,811** |

Ne llogarine "Shpenzime te perllogaritura" Dega ka regjistruar shpenzime te kryera per blerje gjate vitit 2019, faturat e te cilave jane marre gjate muajve te pare te vitit 2020.

## 13. LLOGARI TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE

Llogari te pagueshme ndaj punonjesve me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Te pagueshme ndaj punonjesve:*** | | |
| Pagat neto | 34,459,294 | 12,305,970 |
| Shpenzime te tjera te personelit | 90,095 | 44,606 |
| **Totali** | **34,549,389** | **12,350,576** |

## 14. DETYRIME TATIMORE

Detyrime tatimore me 31 dhjetor 2019 dhe me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Detyrime tatimore:*** | | |
| Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi | 10,165,652 | 3,625,858 |
| Sigurime shoqerore dhe shendetsore | 2,042,353 | 748,410 |
| Provizione per gjoba tatimore | - | 10,000 |
| **Totali** | **12,208,005** | **4,384,268** |

Ne zerin "Detyrime tatimore" perfshihen detyrimet e Deges per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore dhe tatimi mbi te ardhurat personale per muajin dhjetor 2019, te cilat jane paguar ne muajin janar te vitit 2020.

## 15. TE ARDHURAT

Te ardhurat per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019** | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Te ardhura nga kontrata:*** | | |
| Te ardhura nga sherbimet | 510,057,922 | 167,316,370 |
| ***Te ardhura te tjera:*** | | |
| Te ardhura nga falja e detyrimeve nga Shoqeria Meme | 10,286,546 | - |
| **Totali** | **520,344,468** | **167,316,370** |

Ne zerin "Te ardhura nga sherbimet" perfshihen te gjitha te ardhurat e gjeneruara nga sherbimet e kryera ne kuader te projektit per "TAP" gjate vitit 2019.

## 16. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personeli per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Shpenzime per paga | 416,643,584 | 137,099,695 |
| Shpenzime per sigurimet shoqerore dhe shendetsore | 10,176,975 | 3,115,708 |
| **Totali** | **426,820,559** | **140,215,403** |

Dega ka perllogaritur, deklaruar dhe paguar paga dhe kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore" mesatarisht per 19 punonjes gjate vitit 2019.

## 17. SHPENZIME OPERATIVE

Shpenzimet operative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Shpenzime te pergjithshme te alokuara | 18,236,493 | 12,209,646 |
| Shpenzimi udhetimi | 8,606,409 | 2,967,345 |
| Shpenzime sigurimi | 7,395,000 | 1,790,705 |
| Shpenzime te kryera nga Shoqeria Meme | 5,511,563 | - |
| Shpenzime kontabiliteti dhe konsulence fiskale | 4,421,128 | 3,138,522 |
| Shpenzime ligjore | 2,439,322 | 388,095 |
| Shpenzime manaxhimi | 2,240,446 | 1,180,759 |
| Shpenzime per personelin | 1,731,067 | 664,952 |
| Shpenzime konsulence | 1,463,640 | - |
| Shpenzime bankare | 1,330,234 | 527,707 |
| Shpenzime akomodimi | 618,780 | 1,019,920 |
| Shpenzime per viza | 571,995 | - |
| Shpenzime auditimi | 365,310 | 370,260 |
| Shpenzime per leje qendrimi | 225,566 | - |
| Shpenzime te tjera | 215,291 | 119,866 |
| Shpenzime per taksat vendore | 110,750 | 67,000 |
| **Totali** | **55,482,994** | **24,444,777** |

## 18. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet te tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019** | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| Shpenzime te tjera te punonjesve | 233,155 | - |
| Humbje nga mbipagesat | 3,353 | - |
| **Totali** | **236,508** | - |

## 19. FITIM (HUMBJE) NGA KURSET E KEMBIMIT

Fitim (humbje) nga ndryshimet ne kurset e kembimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019** | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Fitim (humbje) nga kurset e kembimit:*** | | |
| Fitim nga kurset e kembimit | 3,466,385 | 11,723,564 |
| Humbje nga kurset e kembimit | (5,707,593) | (5,160,423) |
| **Fitim (humbje) neto nga kurset e kembimit** | **(2,241,208)** | **6,563,141** |

## 20. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 perbehet nga sa me poshte:

| | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019** | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | 35,563,199 | 9,219,331 |
| *Shpenzime te panjohura* | *12,665,452* | *4,772,083* |
| **Fitimi i tatueshem** | **48,228,650** | **13,991,414** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | **7,234,298** | **2,098,712** |
| *Tatimi mbi fitimin i parapaguar* | *5,333,274* | *1,637,636* |
| **Tatimi mbi fitimin per t'u paguar** | **1,901,024** | **461,076** |

Sipas legjislacionit fiskal shqiptar, norma e zbatueshme e tatimit mbi fitimin per vitin 2019 eshte 15% (2018:15%). Deklarimet tatimore plotesohen ne baza vjetore, por fitimet ose humbjet e deklaruara per qellime tatimore mbeten te perkohshme deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat tatimore dhe regjistrimet e tatimpaguesve dhe leshojne nje vleresim perfundimtar.

## 21. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Transaksionet me palet e lidhura per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 perbehen nga sa me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Fonde te marra nga Shoqeria Meme:*** | | |
| Fonde te marra nga Brunel Energy Europe B.V. | 19,483,200 | 43,207,300 |
| **Totali** | **19,483,200** | **43,207,300** |

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Detyrime ndaj paleve te lidhura:*** | | |
| Brunel Energy Europe BV | 32,393,552 | 17,565,151 |
| Brunel Energy Holding BV | 2,240,446 | 1,180,759 |
| **Totali** | **34,633,998** | **18,745,910** |

| | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019** | **Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| ***Sherbime te marra nga palet e lidhura:*** | | |
| Brunel Energy Europe BV | 35,337,617 | 34,571,491 |
| Brunel Energy Holding BV | 2,240,446 | 1,180,759 |
| **Totali** | **37,578,063** | **35,752,250** |

## 22. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Ky shenim permban informacion per ekspozimin e Deges ndaj rrezikut te kredise, rrezikut te likuiditetit dhe rrezikut te tregut. Rreziku i tregut perfshin rrezikun e normes se interesit dhe rrezikun e kurseve te kembimit.

Drejtimi ka pergjegjesi per ngritjen dhe kontrollin e nje plani te pergjithshem per manaxhimin e rrezikut.

### 22.1 Rreziku i kredise

Me 31 dhjetor 2019 Dega nuk eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi i llogarive te arketueshme ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte i lidhur vetem me klientin vendas.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare perfaqeson nivelin maksimal te ekspozimit ndaj rrezikut te kredise. Niveli maksimal i ekspozimit ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte si me poshte:

| | **Me 31 dhjetor 2019** | **Me 31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| Llogari te arketueshme dhe kredi te tjera tatimore | 104,874,690 | 55,958,068 |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet e saj | 19,581,138 | 17,239,427 |
| Te ardhura te perllogaritura | 10,965,658 | - |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2019** | **135,421,486** | **73,197,495** |

## 22. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### 22.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku qe ndryshimet ne cmimet e tregut, si normat e interesit, kurset e kembimit dhe cmimet e kapitalit do te ndikojne ne te ardhurat apo ne vleren e instrumenteve financiare te Deges. Objektivi i manaxhimit te rrezikut te tregut eshte manaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj rrezikut te tregut brenda parametrave te pranueshem duke optimizuar kthimin.

### 22.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit eshte rreziku qe Dega mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Dega menaxhon rrezikun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhet me profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.

| | **deri ne 6 muaj** | **6 deri ne 12 muaj** | **1 deri ne 5 vjet** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|
| Llogari te arketueshme | 104,874,690 | - | - | 104,874,690 |
| Mjete monetare ne banke | 19,581,138 | - | - | 19,581,138 |
| Te ardhura te perllogaritura | 10,965,658 | - | - | 10,965,658 |
| | **135,421,486** | **-** | **-** | **135,421,486** |
| Shpenzime te perllogaritura | (11,118,458) | - | - | (11,118,458) |
| Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera | (83,658,372) | - | (19,483,200) | (103,141,572) |
| | **(94,776,830)** | **-** | **(19,483,200)** | **(114,260,030)** |
| **Rreziku i likuiditetit me 31 dhjetor 2019** | **40,644,656** | **-** | **(19,483,200)** | **10,195,798** |

| | **deri ne 6 muaj** | **6 deri ne 12 muaj** | **1 deri ne 5 vjet** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|
| Llogari te arketueshme | 55,958,068 | - | - | 55,958,068 |
| Mjete monetare ne banke | 17,239,427 | - | - | 17,239,427 |
| | **73,197,495** | **-** | **-** | **73,197,495** |
| Shpenzime te perllogaritura | (1,215,811) | - | - | (1,215,811) |
| Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera | (35,941,830) | - | (43,207,300) | (79,149,130) |
| | **(37,157,641)** | **-** | **(43,207,300)** | **(80,364,941)** |
| **Rreziku i likuiditetit me 31 dhjetor 2018** | **36,039,854** | **-** | **(43,207,300)** | **(7,167,446)** |

### 22.4 Rreziku i valutes

Dega ndermerr transaksione ne monedhe te huaj si pasoje e ekspozimit ndaj luhatjeve te kursit te kembimit. Ekspozimi ndaj kurseve te kembimit manaxhohet duke percaktuar nje politike midis te arketueshmeve dhe pagueshmeve. Vlerat kontabel te aktiveve dhe detyrimeve monetare te Deges sipas monedhave per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 jane paraqitur ne tabelat e meposhtme:

## 22. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### 22.4 Rreziku i valutes (vazhdim)

| | EUR | GBP | USD | LEK | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| Llogari te arketueshme dhe kredi tatimore | 103,506,147 | - | - | 1,368,543 | 104,874,690 |
| Mjete monetare ne banke | 17,789,402 | 533 | 926,793 | 864,409 | 19,581,138 |
| Te ardhura te perllogaritura | 5,511,563 | - | - | 5,454,095 | 10,965,658 |
| | **126,807,113** | **533** | **926,793** | **7,687,046** | **135,421,486** |
| Shpenzime te perllogaritura | (9,898,458) | | | (1,220,000) | (11,118,458) |
| Llogari te pagueshme dhe te tjera | (35,090,050) | - | - | (48,568,322) | (83,658,372) |
| Detyrime ndaj Shoqerise Meme | - | - | - | (19,483,200) | (19,483,200) |
| | **(44,988,508)** | **-** | **-** | **(69,271,522)** | **(114,260,030)** |
| **Rreziku i kursit te kembimit me 31 dhjetor 2019** | **81,818,606** | **533** | **926,793** | **(61,584,476)** | **21,161,457** |

| | EUR | GBP | USD | LEK | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| Llogari te arketueshme dhe kredi tatimore | 54,015,297 | - | - | 1,942,771 | 55,958,068 |
| Mjete monetare ne banke | 7,876,526 | 9,019,861 | 6,999 | 336,041 | 17,239,427 |
| | **61,891,823** | **9,019,861** | **6,999** | **2,278,812** | **73,197,495** |
| Shpenzime te perllogaritura | (678,810) | - | (537,001) | - | (1,215,811) |
| Llogari te pagueshme dhe te tjera | (18,790,516) | - | - | (17,151,314) | (35,941,830) |
| Detyrime ndaj Shoqerise Meme | (38,280,478) | (2,086,015) | 118,839 | (2,959,645) | (43,207,300) |
| | **(57,749,805)** | **(2,086,015)** | **(418,162)** | **(20,110,971)** | **(80,364,942)** |
| **Rreziku i kursit te kembimit me 31 dhjetor 2018** | **4,393,018** | **6,933,846** | **(411,163)** | **(17,832,159)** | **(7,167,446)** |

## 23. NGJARJE TE METEJSHME

Perhapja e COVID-19, e shpallur si pandemi nga Organizata Boterore e Shendetesise ne 11 mars 2020, ka shkaktuar nderprerje te bizneseve dhe aktiviteteve ekonomike ne te gjithe boten. Manaxhimi e konsideron kete perhapje si nje ngjarje jo-rregulluese pas dates se raportimit dhe do te vazhdoje te monitoroje situaten per çdo ndikim te mundshem duke ndermarre gjithashtu te gjitha veprimet e nevojshme per te lehtesuar çdo efekt.

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te rendesishme pas dates se raportimit, te cilat kane nevoje per rregullim apo paraqitje ne keto pasqyra financiare.

*    *    *    *    *